

KONTRATA E SHITJES SE KUOTES INFO-TELECOM NE SHOQERINE DIGICOM SHPK

KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTES

Në Tiranë, sot, më 11 . 06 .2019, palët e mëposhtme lidhin këtë kontratë shitblerje kuote:

Info-Telecom Shpk, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) K92402002P, përfaqësuar rregullisht për qëllim të kësaj Marrëveshje nga z. Marin Gjonaj, mbajtes i leternjoftimit me nr. I50830192B, në cilesinë e Administratorit të "INFO-Telecom" shpk (në vijim e quajtur Shitësi)

dhe

Albanian Telecommunications Union Shpk, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) L01425001U, përfaqësuar rregullisht për qëllim të kësaj Marrëveshje nga z. Bardhyl Vidrica, mbajtes i leternjoftimit me nr. G10502061N, në cilesinë e Administratorit të "Albanian Telecommunications Union" Shpk., (në vijim i quajtur Blerësi)

MEQËNËSE

- A. Shoqëria DIGICOM shpk është një shoqëri e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi të subjektit L42018012R, (me poshte e quajtur "Shoqëria").
- B. Në datën e këtij akti, Shitësi zotëron një kuotë pjesë e kapitalit themeltar të Shoqërisë që përfaqëson 85% të këtij kapitali ("Kuota").
- C. Sipas termave dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Kontratë dhe në Marrëveshjen për Shitblerjen e Kuotës, Blerësi kërkon të blejë dhe përfitojë dhe Shitësi kërkon të shesë dhe transferojë të Blerësi, Kuotën e tij në Shoqëri.
- D. Të dyja palët kanë marrë miratimin e Asamblesë së Ortakëve për lidhjen dhe nënshkrimin e kësaj kontrate për shitblerjen e kuotës ("Kontrata").

Palët bien dakord si vijon:

1. Termat më poshtë do të kenë kuptimet si në vijim, përveç kur konteksti që përdoren dikton ndryshe:

Kontratë do të thotë kjo Kontratë Shitje Kuotash, e cila përbën veprimin juridik të vetëm për kalimin e kuotës nga Shitësi tek Blerësi dhe regjistrohet në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Datë e Kontratës do të thotë data e nënshkrimit të kësaj Kontrate si më sipër.

Marrëveshja për Shitblerjen e Kuotës do të thotë marrëveshja e lidhur midis Shitësit dhe Blerësit datë 29 Tetor 2018.




2. Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi blen dhe pranon nga Shitësi 1 (një) kuotë që përfaqëson dhe siguron pjesëmarrjen me 85% në kapitalin e Shoqërisë, me garanci të plotë mbi titullin dhe të lirë e të pastër nga çdo e drejtë e ndonjë pale të tretë.
3. Kuota ka vlerë nominale në shumën totale 200.517.870,00 (dyqind milione e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e teteqind e shtatëdhjetë) lekë.
4. Çmimi i shitjes është EURO 3.300.000,00 (tre milion e treqind mijë euro).
5. Çmimi i shitjes së kuotës, pagesa e çmimit të shitjes së kuotës dhe garancitë apo angazhime të tjera të Palëve kryhen, permbushen dhe ruhen sipas kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen për Shitblerjen e Kuotës.
6. Titulli i pronësisë mbi Kuotën i transferohet Blerësit menjëherë në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
7. Pas nënshkrimit/kalimit të pronësisë, Blerësi do të jetë ortak zotërues i 1 (një) kuote që përfaqëson 85% të kapitalit të Shoqërisë, ndërsa Shitësi e humb pronësinë mbi Kuotën dhe nuk do të jetë më ortak në Shoqëri.
8. Shitësi autorizon nëpërmjet kësaj Kontrate regjistrimin e transferimit të pronësisë së Kuotës si më sipër në emrin dhe pronësinë e Blerësit në Regjistrin Tregtar shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Blerësi do të përgatisë dhe depozitojë të gjitha aplikimet e nevojshme që kërkohen për depozitimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate në Regjistrin Tregtar shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
9. Për çështjet të cilat nuk janë të parashikuara në këtë Kontratë apo që mund të rrjedhin prej saj, duke përfshirë edhe përllogaritjen e tatimeve/taksave që mund të lindin nga transaksioni, do të zbatohet legjislacioni përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
10. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të kësaj Kontrate në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Kontrate, nëse nuk zgjidhet me mirëkuptim mes vetë palëve, kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
11. Kjo Kontratë përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe. Palët deklarojnë se kuptojnë përmbajtjen e saj dhe e nënshkruajnë me vullnet të plotë e të lirë.

SHITESI

Info-Telecom Shpk


Administratori



BLERESI

Albanian Telecommunications Union Shpk

Administratori



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 2825 Rep.

Nr. 493 Kol. 12



DEKLARATË NOTERIALE

Sot, më datë 05.06.2019 (dy mijë e nëntëmbëdhjetë) para meje Noterit, Loriana A. Robo, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli në Rrugë "Ismail Qemali", P. 27/1, u paraqit personalisht:

Z. Marin Gjonaj, i biri i Besnik, shtetas shqiptar, i datëlindjes 30.08.1985, lindur dhe banues në Tiranë, identifikuar nëpërmjet Pasaportës Shqiptare me Nr. Pasaportën me nr. BR9864209 dhe Nr. Personal I50830192B, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili më deklaroi sa më poshtë:

"Unë, deklaruesi Marin Gjonaj, i biri i Besnik, shtetas shqiptar, i datëlindjes 30.08.1985, lindur dhe banues në Tiranë, identifikuar nëpërmjet Pasaportës Shqiptare me Nr. Pasaportën me nr. BR9864209 dhe Nr. Personal I50830192B, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakut zotërues të 1 (një) kuote që përfaqëson 15% të kapitalit në shoqërinë "DIGICom" shpk, shoqëri e së drejtës shqiptare, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nr. Nuis L42018012R,

Pasi jam njohur me ofertën e shoqërisë "INFO-Telecom" shpk, shoqëri zotëruese e 1 (një) kuote që përfaqëson 85% të kapitalit në shoqërinë "DIGICom" shpk, për blerjen e kuotës me cmim 3.300.000 (tre milion e treqind mijë) Euro

Deklaroj se:

- 1. Nuk kam asnjë interes për blerjen e kuotës që shoqëria "INFO-Telecom" shpk zotëron në shoqërinë "DIGICom" shpk, shoqëri e së drejtës shqiptare, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nr. Nuis L42018012R.*
- 2. Konsideroj të përmbushur detyrimin e shoqërisë "INFO-Telecom" shpk për respektimin e të drejtës time të parablerjes së kuotës në përputhje me nenin 10 pika 3 të Statutit të shoqërisë "DIGICom" shpk.*
- 3. Refuzoj blerjen e kuotës që shoqëria "INFO-Telecom" shpk zotëron në shoqërinë "DIGICom" shpk në përputhje me nenin 10/3/(ii) të Statutit të shoqërisë "DIGICom" shpk.*
- 4. Jap pëlqimin që kuota që shoqëria "INFO-Telecom" shpk zotëron në shoqërinë "DIGICom" shpk të transferohet lirisht tek ofertuesi shoqëria "Albanian Telecommunications Union" shpk.*
- 5. Jap pëlqimin që kjo deklaratë të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit së bashku me praktikën e shitjes së kuotës së shoqërisë "INFO-Telecom Shpk"*

Unë Noteri, pasi dëgjova deklaratimet e bëra prej deklaruësit dhe verifikova dokumentet përkatëse, konstatova se deklaratata është në përputhje me vullnetin e lirë dhe të plotë të deklaruësit, gjithashtu edhe konform ligjit, dhe për këtë unë Noteri vërtetoj nënshkrimin e tij dhe e nënshkruaj këtë akt duke i dhënë forcën e nevojshme ligjore.

Ky akt redaktohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

DEKLARUESI

Marin Gjonaj

Marin Gjonaj




NOTER

Loriana A. ROBO

Loriana Robo

Marin Gjonaj


**TAKSA E PULLËS
E PAGUAR**
Noter Loriana A. Robo